



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 01.09.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 30.08.2022, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Euroasphalt" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i rrugës Tahir Zajmi Carrapatok-Kontratë dy vjeçare", Nr. i prokurimit- 632-22-7610-5-2-1, nxjerr:

V E N D I M

1. **Aprovohet si pjesërishtë e bazuar** kërkesa për ri-shqyrtim e dt.30.08.2022, e parashtruar nga Operatori Ekonomik "Euroasphalt" SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i rrugës Tahir Zajmi Carrapatok- Kontratë dy vjeçare", Nr. i prokurimit- 632-22-7610-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-076-521, kundër Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë te AK –së, të datës 29.07.2022, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Përmirësohet pjesërisht DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, publikuar me datë: 29.07.2022;**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të bëj përmirësimin e pjesërishtëm të Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik " Euroasphalt" SH.P.K, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, me dt.30.08.2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i rrugës Tahir Zajmi Carrapatok- Kontratë dy vjeçare " , Nr. i prokurimit- 632-22-7610-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-076-521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 01.09.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pas shqyrtimit të Kërkesës për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik " Euroasphalt" SH.P.K, të dt.30.08.2022, Autoriteti kontraktues, konstaton se pretendimet e Operatorit në fjalë, janë pjesërisht të bazuara, prandaj vendos që të bëj përmirësimin e pjesërishtëm të Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;

